



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane
Mbledhja nr. 42
Prishtinë, më 27.02.2012, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Blerta Deliu – Kodra, Vjosa Osmani, Blerim Shala dhe Albert Kinolli.

Munguan: Sasha Milosavljeviq, Fatmir Limaj, Alma Lama dhe Suzan Novobërdali.

Stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri dhe Adelina Demolli.

Pjesëmarrës të tjerë: Venera Mjekiqi- Kuvend, Dritero Arifi- MIE.

Mbledhjen e kryesoi, Lutfi Haziri- kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të datave 19.12.2011, 30.01.2012 dhe 06.02.2012;**
- 3. Raportimi i z. Hajredin Kuçi – zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë;**
- 4. Të ndryshme.**

***Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet si në vijim.

3. Raportimi i z. Hajredin Kuçi, zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë

Kryetari- Tha se pas raportimit të Ministres së Integritimit Evropian, kemi qenë në monitorim të disa ministrive. Ju kemi ftuar që të raportoni për veprimet që i keni ndërmarrë si Ministri për të përmbushur vërejtjet që kanë dalë nga Raporti i Progresit. Njoftoi se në muajin mars do të hartohet raporti i Komisionit për të arriturat në përmbushjen e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës. Fjalën ia dha Ministrit.

Hajredin Kuçi – Zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë -Ne e shohim Raportin e Progresit si pjesë të obligimeve tona, ku në të janë punët tona të pakryera. Lidhur me sfidën për zbatimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, tha se Ligji i lartpërmendur është përpiluar dhe ka arritur përkrahjen e nevojshme të Qeverisë dhe të Kuvendit. Më saktësisht, ndryshimi kyç në këtë Ligj është zvogëlimi i numrit të gjyqtarëve të EULEX-it dhe rritja e numrit të gjyqtarëve vendorë. Sa i përket sfidës se “*Sistemi gjyqësor mbetet i dobët, derisa efikasiteti duhet avancuar*”, theksoi se Ministria nën frymën e ndarjes së pushteteve, ka kompetenca tejet të kufizuara në sistemin gjyqësor. Kompetencat që ajo i ka tani, kanë të bëjnë me krijimin e politikave për administrimin e drejtësisë në përgjithësi dhe përkrahjen e KGJK-së. Nisma kryesore që është bërë në këtë drejtim nga Ministria e Drejtësisë është sigurimi i buxhetit për 140 gjyqtarë më shumë. Lidhur me sfidën “*Ekzistojnë brenga serioze për transparencën kur vjen tek zbatimi i Ligjit mbi faljen*” tha se siç është e paraparë edhe në Ligjin mbi Faljen, falja është kompetencë ekskluzive e Presidentit. Për më tepër, angazhimi i Ministrisë së Drejtësisë sipas ligjit shihet si fakultativ, pasi që “*Presidenti mund ta udhëzojë Ministrinë që të mbledh informatat e nevojshme*”. Këtë vit, Shërbimi Korrektues në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë është angazhuar që të ofrojë për zyrën e Presidentes informatat në mënyrën më korrekte të mundshme, sipas kërkesës që ka bërë ajo. Lidhur me këtë sfidë kërkoi edhe mbështetjen e Komisionit për hartimin e projektligjit për Amnistinë me të cilin ligj do të caktoheshin në mënyrë precize të gjitha rrethanat dhe veprat për të cilat do të bëhej amnistia. Lidhur me sfidën “*Kosova vazhdon të përballet me sfida të konsiderueshme në luftimin e korrupsionit*” tha se si institucion për krijimin e politikave, Ministria e Drejtësisë është angazhuar sikur vitin e kaluar, ashtu edhe në këtë vit për të plotësuar infrastrukturën ligjore për luftimin e korrupsionit në veçanti. Në këtë drejtim, duhet përmendur veçanërisht Kodin e ri Penal, i cili është tani në shqyrtim në Kuvend. Ky Kod, në veçanti ashpëson edhe më tej luftën kundër korrupsionit, duke qartësuar më tej dispozitat ekzistuese, por edhe duke shtuar gjithashtu shumë dispozita të reja për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe janë rritur ndjeshëm dënimet për këto vepra. Për sfidën: “*Shkeljet e rregullave të prokurimit vazhdojnë të jenë brengosëse në kontekstin e korrupsionit*”, Ministria e Drejtësisë ka filluar të përgatitet për të gjetur donacione, përkitazi me instalimin e prokurimit elektronik. Kjo do të bëhet pas kompletimit të Ligjit të ri mbi prokurimin publik me aktet përkatëse nënligjore. Njoftoi që si rezultat i një artikulli në gazetë dhe anulimin e dy vendimeve nga OSHP-ja, Ministria e Drejtësisë ka reaguar menjëherë, duke suspenduar nga puna udhëheqësen e Zyrës së prokurimit në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe ka lëshuar disa vërejtje me shkrim për zyrtarë të tjerë të prokurimit. “*Shërbimi Korrektues vazhdon të përballet me vështirësi në sigurimin e fondeve për riparime. Ndërtimi i burgut të sigurisë së lartë duhet përfunduar sa më shpejt që është e mundur*”. Ministria e Drejtësisë ka përgatitur një sërë masash të cilat do të ndërmerren për të përmirësuar infrastrukturën ekzistuese të

objekteve në qendrat korrektuese dhe qendrat e paraburgimit, në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Ndërkaq, sa i përket ndërtimit të Burgut të Sigurisë së Lartë, komiteti i themeluar për përcjelljen e punimeve për ndërtimin e Burgut të Sigurisë së Lartë ka mbajtur takime të rregullta me qëllim të përcjelljes së progresit sa i përket ndërtimit të këtij Burgu. Sfidë e radhës është: *“Gazetarët vazhdojnë të përballen me presione politike dhe frikësim, gjë që kërcënon gazetarinë hulumtuese, e cila është ende e brishtë. Ndryshimi i Kodit Penal, që do t'i jepte fund shpifjes si vepër penale, ende nuk është miratuar. Standardet profesionale në gazetari duhen avancuar”*. Njoftoi se me Kodin e ri Penal të Kosovës, kjo më nuk parashihet si vepër penale. Kjo çështje rregullohet me Ligjin civil kundër shpifjes dhe fyerjes. Ai tha se me shumë rëndësi është edhe propozimi i Ministrisë së Drejtësisë që të rriten apo ashpërsohen dënimet për disa nga veprat penale kundër jetës dhe trupit, për rastet kur ato kryhen ndaj një punonjësi të medias. Ministria e Drejtësisë ka konsideruar se është tejet e rëndësishme që gazetarët të gëzojnë një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kodit Penal dhe gjithë sistemit tonë juridik, prandaj ka propozuar që nenet e lartcekura të përmbajnë dënime së paku 20% më të ashpra kur ato kryhen ndaj një punonjësi të medias, *nëse motivi i kryerjes së asaj vepre penale është profesioni i tij/saj prej gazetari apo punonjësi të medias*. Dhe për fund, Ministria e Drejtësisë tha se ka propozuar që këto raste të trajtohen me prioritet nga gjykatat.

Vjosa Osmani- Tha se edhe në Raportin e Progresit të vitit të kaluar është konstatuar që Ministria e Drejtësisë ka arritur që të përmbushë sfidën e hartimit të legjislacionit për dikasterin të cilin e mbulon, por kërkoi që të gjendet buxhet i nevojshëm për implementimin e tyre. Shtoi se, që të gjithë jemi pajtuar që ekziston një rrezik i veçantë që mosfunksionimi i gjykatave të Kosovës në veri do të çojë deri te shkelja e parimit kushtetues që ka të bëjë me sistemin unik gjyqësor. Lidhur me mosfunksionimin e tyre, tha se e kuptojmë që është çështje e sigurisë, mirëpo këto gjykata kanë funksionuar edhe në kohën kur rreziku ka qenë edhe më i madh. Ajo pyeti, nëse ka pasur ndonjë insistim nga ana e tyre, në mënyrë që zëvendëskryeministrja Edita Tahiri, të insistojë që kjo çështje të jetë parësore në vazhden e dialogut me Serbinë, dhe nëse nuk ka sukses në këtë drejtim, të pezullohet dialogu, apo në një mënyrë të kushtëzohet. Më tej, ajo tha se nëse vazhdohet me këtë tendencë të kompromiseve të njëpasnjëshme, kjo mund të jetë një ndër elementët e radhës, ku edhe më tej do të kishim cenim të integritetit territorial. Tha se presim nga Ju, pasi që edhe e mbuloni këtë sektor, që të insistoni tek Ekipi Negociator i Kosovës, që vërtet ta ketë këtë si çështje parësore në të cilën nuk do të bëhet absolutisht asnjëherë kompromis.

Blerim Shala- Si Ministri e Drejtësisë, përveç detyrimeve ndaj Raportit të Progresit, ju keni detyrime që ndërlidhen edhe me procesin e përmbylljes së pavarësisë. Pyeti: Sa janë komplementare këto dy procese dhe a mendoni se prania ndërkombëtare në fushën e gjyqësorit dhe sundimit të ligjit do të jetë e mirëseardhur edhe atëherë kur pavarësia e mbikëqyrur do të konkludohet?

Blerta Deliu-Kodra – Në Raportin e Progresit janë paraqitur katër raste ku gazetarët janë ndjerë të kërcënuar që ta bëjnë punën e tyre. Kjo është një sfidë, e cila po na përcillet në Raportet e Progresit. Pyeti: Me ndryshimet që janë bërë në Projektkodin e ri Penal, sa do

të ndikohet që gazetarët të jenë të lirë ta bëjnë punën e tyre dhe sa do të ndikojë kjo në avancimin e punës së tyre profesionale?

Hajredin Kuçi – Zëvendëskryeminister dhe Ministër i Drejtësisë- Në momente të caktuara kemi propozuar projektligje që lidhen me Raportin e Progresit, por që kanë pasur vështirësi buxhetore. Një ndër ta është edhe Ligji për dëshmitar të mbrojtur, i cili mu për këtë nuk do të hyjë në fuqi deri në muajin shtator të këtij viti. Ne nuk kemi mundur të presim dhe të mos i kryejmë punët tona, duke pritur deri të gjendet buxheti. Sa i përket funksionalitetit të gjyqësorit në vend, tha se ne i kemi vënë tri kushte: sistemi të jetë unik në tërë vendin, të ketë ligje të njëjta të aplikueshme në gjithë Republikën e Kosovës dhe të ketë hierarki të emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga Këshilli Gjyqësor, respektivisht Këshilli Prokurorial i Kosovës. Këto janë tri vija, brenda të cilave duhet të funksionojnë. Më pas, ai tha se është shumë e vërtetë që mosfunksionimi i Gjykatës së Qarkut në veri të vendit, ndikon edhe në shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut në vend. Njoftoi se Ministria e Drejtësisë ka bërë projekt për këtë dhe të njëjtin e ka dorëzuar te EULEX-i, pasi që nuk kanë menduar që kjo çështje duhet të jetë pjesë e dialogut, ngase është konsideruar se është pjesë e brendshme e vendit, dhe si të tillë, të mos i japin mundësi që dikush tjetër të bisedojë për të. Këtë dialog duhet ta bëjmë me EULEX-in dhe KFOR-in. Kemi marrë premtime shumë shpesh, mirëpo këto premtime nuk janë realizuar dhe besoj që këtu është rruga e EULEX-it dhe KFOR-it për sigurimin e kushteve të sigurisë. Procesi i përfundimit të mbikëqyrjes së pavarësisë, apo misioni civil ndërkombëtar me procesin e rendit dhe ligjit në Kosovë do të lëvizin paralelisht, por nuk do të përfundojnë në të njëjtën kohë. Procesi i mbikëqyrjes së pavarësisë duhet të përfundojë brenda këtij vitit, ndërsa procesi i EULEX-it duhet të jetë në tranzicion. Kemi menduar tri faza deri tek marrja e përgjegjësisë, ato janë: ndarja e përgjegjësisë ekzekutive, mbikëqyrja dhe këto duhet të përfundojnë brenda dy viteve. Krejt kjo bëhet për të lëvizur agjendën tonë nga ajo që është me EULEX-in për integrimet evropiane ku edhe aty ka kritere, bashkëpunim dhe mbikëqyrje. Sa i përket çështjes së gazetarëve, tha se me kodin e ri, gazetarët janë shumë më të avancuar dhe duhet të ndihen mirë që shpifja dhe fyerja janë hequr nga Kodi Penal. Jam i bindur se kushtet legale për avancim të punës profesionale ekzistojnë në Kosovë.

Vjosa Osmani- Sa i përket sistemit unik gjyqësor në Kosovë, tha se qëllimi nuk ishte që të kërkohet që të dialogohet me Serbinë për këtë çështje, por megjithatë kushtëzimi do të tregonte sukses në rezultatet e këtij dialogu, duke pasur parasysh që nuk mund të flitet për bashkëpunim rajonal përderisa Serbia përmes strukturave paralele në territorin tonë e bllokoi funksionimin e këtij sistemi unik gjyqësor dhe doganor. Tha se pikërisht presim nga Ju që këtë mesazh t'ia dërgoni në mënyrë shumë të qartë zëvendëskryeminstres, e cila pastaj e përçon në këtë dialog, që mos të lejohet që as mos të hapet kjo temë, por megjithatë të shfrytëzohet si kusht në temat tjera që janë duke u diskutuar, siç është bashkëpunimi rajonal apo edhe menaxhimi i integruar i kufirit.

Albert Kinolli- Tha se ekziston një boshllëk për gjyqtarë dhe prokurorë, kur pritet të mbushet ky boshllëk, ndërsa sa i përket ndërtimit të Burgut të Sigurisë së Lartë, tha se kur pritni që të përfundojë ndërtimi i tij?

Kryetari- Tha se ju mbështes që të hartoni draftligjin për amnisti, sepse konsideroj që Presidentja në detyrë, që ka bërë shkelje apo ripenalizim të të dënuarve, që ligji ua njuh të drejtën, që sipas sjelljes së mirë të kërkojnë amnisti. Për shkak të vërejtjes që është dhënë në Raportin e Progresit të vitit të kaluar, është shkuar në minimum të shqyrtimit dhe ju treguat që si Ministër keni qenë i “përjashtuar” nga kjo mundësi, pra që ta keni në tretman të drejtën e të burgosurve që ligji ua njuh këtë të drejtë. Një ligj i tillë do ta rregullonte këtë çështje dhe nuk do të mbetej në duart e një autoriteti. Pyeti se a konsideroni se Këshilli Kombëtar për luftë kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe trafikimeve, ka kaluar në kompetenca të Presidentes, përkundër mekanizmave kushtetues si ngushëllim nga dështimet që ka pësuar departamenti apo task forca e ndërtuar nga Qeveria, mekanizëm ky profesional dhe efikas të cilin ju e keni arsyetuar më së shumti si departament, i cili do të jetë i pamëshirshëm për luftimin e krimit dhe korrupsionit. Pra, ky Këshill, a lidhet me dështim apo me tendencë që të punojë diçka?

Hajredin Kuçi – Zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë- Tha se integrimi i veriut ka të bëjë me rendin dhe ligjin, që nënkupton gjyqësor funksional, forcim të zinxhirit komandues në Policinë e Kosovës dhe kontrollin e plotë të pikave doganore. U pajtua që pjesë e saj mund të jetë jo çështje e brendshme, por mosndërhyrja në çështjet e brendshme. Emërimi i prokurorëve dhe gjyqtarëve tha se është punë qind për qind e pavarur nga Ministria e Drejtësisë, por ne kemi kryer obligimet tona duke siguruar fond të veçantë për 142 gjyqtarë dhe 45 prokurorë, gjithashtu kemi krijuar infrastrukturën e domosdoshme ligjore për emërimin e pavarur të tyre. Tha se jam shumë i bindur se deri më 1 janar 2013, duhet të jetë i kompletuar gjyqësori dhe prokurorët dhe do të jetë një strukturë e re sipas ligjeve që i kemi miratuar në Kuvend. Sa i përket faljes, ai konsideroi se falja është institut i drejtësisë që i takon njeriut me sjelljen e tij, me veprimet e tij dhe nuk lidhet me numra. Njoftoi se Zyra e Presidentes ka dërguar një shkresë tek Shërbimi Korrektues dhe jo tek Ministri, gjë që paraqet shkelje të ligjit. Çështja e amnistisë është çështje kushtetuese, andaj nëse Komisioni Kushtetues e bën kategori kushtetuese, unë do të përgatis Ligjin për amnisti shumë shpejt, sepse kështu nuk do të varej nga individë të caktuar, por do të varej nga nenet e caktuara. Sa i përket Këshillit Kombëtar, tha se e kam kuptuar këshillin si organ konsultativ dhe kam shkuar në atë Këshill, duke menduar se është organ konsultativ dhe po të njëjtin mendim e kam edhe sot. Ai Këshill nuk është obligativ dhe kompetencat janë të ndara. Politikat e drejtësisë i bën Ministria e Drejtësisë, ekzekutimin e tyre e bën gjyqësori dhe prokuroria, andaj edhe nuk mund të ndërhyjmë në pavarësinë e tyre. Sa i përket task forcës, tha se është organi më rezultativ në rajon. Për një vit, mund të shohim veprimet e tyre dhe njerëzit që punojnë aty janë njerëz profesional. Askush nuk mund ta zëvendësojë task forcën apo institucionet e drejtësisë.

Kryetari- Armiku kryesor për liberalizimin e vizave është azilkërkimi. Azilkërkimi është i lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore. Në veprimet që ju i keni prezantuar, thuhet se nga perspektiva e gjykatave të Kosovës nuk shihet si krim i organizuar dhe se edhe rastet kur janë në grup gjykohen individualisht për t'i dhënë dënim minimal. A keni ndërmarrë diçka që të sqaroni apo të kategorizoni këtë veprim, në mënyrë që të përmirësojmë edhe këtë raport?

Hajredin Kuçi – Zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë- Tha se, Ministria e Drejtësisë i ka marrë dy masa në këtë drejtim. Në Kodin e ri Penal, kjo është paraparë në kuadër të veprave të krimit të organizuar dhe janë paraparë dënime më kapitale sesa kanë qenë dhe se Departamenti kundër trafikimit të qenieve njerëzore, që ka qenë në Ministrinë e Drejtësisë, është bartur në Prokurorinë e Shtetit. Arsyeja e kësaj bartjeje është se prokurorët janë ata që komunikojnë me njerëzit që janë objekt i trafikimit. Me Kodin e ri është paraparë që ato vajza të cilat janë objekt i trafikimit të qenieve njerëzore, nëse bashkëpunojnë me organet e prokurorisë dhe gjyqësisë, nuk do të jenë objekt i procedurës penale.

Vjosa Osmani- Sa i përket amnistisë, për momentin, Komisioni Kushtetues nuk ka kompetencë që të prekë çështjet që dalin jashtë suazave të kompetencave të presidentit dhe zgjedhjes së tij. Pyeti: A keni shqyrtuar mundësinë që të hartoni Ligjin për amnisti dhe t'ia propozoni Kuvendit, pasi që një veprim i tillë nuk do të binte ndesh me Kushtetutën, sepse ajo s'e ndalon ndërmarrjen e një veprimi të tillë? Shpeshherë potencohet mungesa e gjyqtarëve dhe prokurorëve të kualifikuar dhe propozoi që Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Fakultetin Juridik, të themelojë një mekanizëm, që qysh gjatë studimeve do të identifikonte një numër të rëndësishëm të studentëve të cilët në faza shumë të hershme do të përgatiteshin për profesionin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kjo formë e përzgjedhjes dhe përgatitjes së studentëve tha se ekziston edhe në disa vende, të cilat kanë pasur probleme të mëdha në fushën e sundimit të ligjit dhe të gjyqësorit efikas. Shtoi se ne tani i kemi të gjitha fondet e fokusuara në gjyqtarët dhe prokurorët e tanishëm, por s'po mendojmë se çka do të ndodhë në të ardhmen.

Blerta Deliu- Kodra- Tha se këtë vit është paraparë edhe themelimi i Institutit për Krime të Luftës në Kosovë. Ku kanë shkuar përgatitjet dhe çfarë po bëhet në këtë drejtim?

Hajredin Kuçi- Zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë- Sa i përket çështjes së amnistisë, tha se ka kohë që i ka dërguar letër Presidentes, Kryetarit të Kuvendit dhe Kryetarit të Komisionit Kushtetues, sepse kam menduar se, nëse e përgatis ligjin më herët, do të dilja jashtë asaj që është paraparë. Pasi që edhe Qeveria ka të drejtë të bëjë amendamentimin e Kushtetutës, nëse nuk lëviz çështja nga Presidenca apo Komisioni Kushtetues i Kuvendit, Qeveria e Kosovës do ta propozojë një amendamentim të tillë. Ne jemi munduar që të mos krijojmë përshtypjen, që përmes këtij organizimi do të lirohen të gjithë, sepse logjika e të burgosurve është që përmes amnistisë do të lirohen të gjithë. Sa i përket çështjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve, tha se është e vërtetë që ne punojmë me një brumë të vjetër dhe logjika e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj ende nuk ka filluar. Gjatë periudhës '89-2002, ne nuk kemi pasur provim të jurisposidencës dhe për trembëdhjetë vite me radhë ne nuk kemi përgatitur asnjë kandidat. Në Akademinë e Drejtësisë kemi paraparë një metodë të tillë më 1 janar 2013 dhe duhet të plotësohet numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve, pastaj mesatarisht për vit duhen 20 deri 30 gjyqtarë apo prokurorë të rinj. Akademia e Drejtësisë parasheh përgatitjen e kandidatëve që nga Fakulteti Juridik. Në Bordin e Akademisë kam paraparë që të jetë edhe Dekani i Fakultetit Juridik, ku si kriter për pjesëmarrje në Akademi duhet të shihet nota mesatare dhe drejtimi që përcaktohet që nga studimet. Lidhur me Institutin për Krime të Luftës tha

se këtë vit do të përgatisim një ligj për të, sepse ai institut është tërësisht i pavarur për hulumtimin e së vërtetës dhe prezantimin e mundësive, që Kosova në momentin kur do ta ngritë padinë për gjenocid, krime lufte, krime kundër njerëzimit në Kosovë, ta kemi të dokumentuar, pra ky është qëllimi i këtij instituti. Kemi marrë modele edhe nga vendet e tjera dhe konsiderojmë se do të arrijë shumë mirë të veprojë, duke përmbushur qëllimin për të cilin është themeluar.

Kryetari- E falënderoi për bashkëpunim dhe raportim para Komisionit.

2. Miratimi i procesverbaleve të datave 19.12.2011, 30.01.2012 dhe 06.02.2012

Procesverbalet e datave 19.12.2011, 30.01.2012 dhe 06.02.2012 u miratuan pa vërejtje.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Lutfi Haziri